



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Duke u bazuar në Planin e mobilitetit të qëndrueshëm për komunën e Vitisë, të aprovuar me vendim nga Kuvendimi Komunal i Vitisë, të datës: 31.03.2016 me numër të protokollit 01-013/374, Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit shpallë këtë:**

## NJOFTIM PUBLIK

### LIDHUR ME KONSULTIMIN PUBLIK PËR PROJEKTIN IDEOR

### “ RREGULLIMI I SHESHIT NË QENDËR TË VITISË”

Projekti ideor “Rregullimi i sheshit në qendër të Vitisë” ka për qëllim krijimin e sipërfaqeve për lëvizje të lirë dhe krijimin e sheshit “Nijazi Azemi” pa automjete në qendër të qytetit dhe bashkimin e tij me parkun e qytetit me të njëjtin emër. Me këtë synohet që qendra e qytetit të Vitisë, të shndërrohet në hapësirë për lëvizje të lirë të këmbësorëve dhe çiklistëve duke zhvendosur parkimin nga sheshi “Nijazi Azemi” dhe duke bllokuar komunikacionin për lëvizjen e mjeteve motorike për një interval të caktuar kohor.

Ky projekt ideor do të jetë në shqyrtim publik prej datës: **01.06.2020 deri 01.07.2020**.

Duke u bazuar në gjendjen e krijuar nga virusi pandemik COVID-19, nuk do të mbahet një diskutim publik por të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo komentet mund të dërgohen në formë elektronike të: [xhelal.musa1@gmail.com](mailto:xhelal.musa1@gmail.com) deri me datë: 01.07.2020.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij projekti, Komuna e Vitisë, konkretisht Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, ka publikuar këtë propozim dokument në ueb faqen zyrtare të Komunës së Vitisë, [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti) në rubrikën “Dokumentet në Shqyrtim Publik”,

I mirëpresim komentet tuaj...

Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun

Komuna Viti